



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/108
Datë: 25.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Autorizohet Kryeministri i Republikës së Kosovës për nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komunës së Prishtinës.
2. Qëllimi i Memorandumit të Mirëkuptimit nga pika 1. e këtij vendimi është arritja e objektivave të përbashkëta dhe konfirmimi i bashkëpunimit për planifikimin dhe zhvillimin e përbashkët dhe të njëkohshëm të projektit "Prishtina e Re", i cili ngërthen në vete ndërtimin e Kompleksit (Rezidencave) Qeveritar dhe Qendrës Administrative të Kryeqytetit në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/108
Datë: 25.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi për t'iu drejtuar Kuvendit të Republikës së Kosovës për tërheqjen e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-058 dhe Ligjin Nr. 04/L-122 si dhe Ligjin Nr. 03/L-073 për Zgjedhje të Përgjithshme në Republikën e Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-256.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin bashkë me kërkesën për tërheqjen e Projektligjit nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 03/108
Datë: 25.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani i Veprimit për Garën Republikane për Kreativitet Kulturor dhe Mendim Kritik për vitin 2019.
2. Mjetet për realizimin e Planit të Veprimit për Garën Republikane për Kreativitet Kulturor dhe Mendim Kritik për vitin 2019 ndahen nga këto organizata buxhetore:
 - 2.1. Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë 53,300.00 euro për ndarjen e bursave dhe realizimin e aktiviteteve për kampe;
 - 2.2. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit 53,300.00 për ndarjen e bursave dhe realizimin e aktiviteteve për kampe;
 - 2.3. Zyra e Kryeministrit 53,300.00 euro për pjesën e mbetur të aktiviteteve të parapara sipas pikës 1 të Planit të Veprimit.
3. Obligohen institucionet nga pika 2 e këtij vendimi që mjetet financiare t'u barten palëve të treta.
4. Obligohen institucionet kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/108
Datë: 25.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 06/107 të datës 18.06.2019 lidhur me Bordin e Ndërmarrjes Publike Qendrore N.P.H. Ibër Lepenc Sh.A

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1. e Vendimit Nr. 06/107 të datës 18.06.2019, si në vijim:
z. Liridon Zogjani emërohet anëtar i Bordit Drejtues të Ndërmarrjes Publike Qendrore N.P.H. Ibër Lepenc Sh.A, e zëvendëson z. Naim Gashin.
2. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi kryen detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/108
Datë: 25.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhje të mbajtur më 25 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni për hartimin e Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-023 për Personat e Zhdukur (tutje: Komisioni) në këtë përbërje:

- | | | |
|---|---|------------|
| 1.1. Z. Kushtrim Gara | Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur, | kryesues; |
| 1.2. Z. Jahja Lluka | Këshilltar politik i Kryeministrit, | anëtar; |
| 1.3. Z. Mentor Borovci | Drejtor i Zyrës Ligjore - ZKM | anëtar; |
| 1.4. Z. Ibrahim Makolli | Delegacioni i Kosovës - Grupi Punues për të Zhdukurit | anëtar; |
| 1.5. Z. Arben Krasniqi | Drejtor i Sekretariatit Koordinues të Qeverisë, | anëtar; |
| 1.6. Z. Xhavit Bulliqi | Zyra Ligjore - ZKM | anëtar; |
| 1.7. Znj. Arife Gashi | Sekretariati Koordinues i Qeverisë - ZKM, | anëtare; |
| 1.8. Znj. Arlinda Likaj Sejdiu | Koordinatorë për Integrim Evropian - ZKM | anëtare; |
| 1.9. Z. Shaban Ademi | U.d. Drejtor i Zyrës për Buxhet dhe Financa - ZKM, | anëtar; |
| 1.10. Z. Arif Panxha | Divizioni Gjuhësor - ZKM, | anëtar; |
| 1.11. Znj. Minire Begaj | Departamentit Ligjor - MPMS, | anëtare; |
| 1.12. Z. Mentor Tërshnjaku | Këshilltar i Ministrit - MPMS, | anëtar; |
| 1.13. Z. Altin Ademi | Këshilltar i Ministria - MD, | anëtar; |
| 1.14. Z. Ilir Gutaj | Departamenti për Drejtësi Tranzicionale - MD, | anëtar; |
| 1.15. Z. Valon Gashi | Departamenti për Kriteria Politike - MIE, | anëtar; |
| 1.16. Përfaqësues nga Departamenti i Buxhetit - MF, | | anëtarë/e; |


2. Me pajtimin e Kryesuesit të Komisionit mund të ftohen edhe përfaqësues të institucioneve të tjera publike, organizatave ndërkombëtare dhe organizata të Shoqërisë Civile si dhe persona të tjerë, përfshirë, por jo kufizuar:

- 2.1. Z. Sheremet Ademi, Përfaqësues i Shoqatave të familjeve të personave të zhdukur;
- 2.2. Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur - ICMP;
- 2.3. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq - ICRC;
- 2.4. Ambasada e Shteteve të Bashkuara;
- 2.5. Ambasada Britanike;

- 2.6. Ambasada Zvicerane;
- 2.7. Zyra e Bashkimit Evropian;
- 2.8. Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim – UNDP.

3. Me qëllim të kryerjes efikase të aktivitetit të tij, Komisioni mund të formojë grupe punuese të përkohshme si dhe mund të ftojë ekspertë.
4. Komisioni është i obliguar që për punën e tij t'i raportojë Qeverisë kurdo që kërkohet raport për ecurinë e punës së Komisionit.
5. Zyra e Kryeministrit obligohet për sigurimin e kushteve materiale, teknike dhe kushteve tjera për punën e këtij Komisioni.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/108
Datë: 25.06.2019


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për Hartimin e Programit për Reforma në Ekonomi 2020-2022

1. Qeveria e Republikës së Kosovës përgatitë Programin për Reforma Ekonomike 2020-2022 (në vijim PRE), si pjesë e dialogut ndërmjet BE-së dhe Republikës së Kosovës në kuadër të qeverisjes ekonomike.
2. PRE mbulon periudhën afatmesme tre vjeçare 2020-2022 dhe bazohet në kornizën makro-fiskale, prioritetet e reformave strukturore dhe masat përkatëse që janë pjesë e Programit të Qeverisë 2017-2021 dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021.
3. Duke u bazuar në Udhëzimet e Komisionit Evropian, përmes Programit për Reforma në Ekonomi raportohet për zbatimin e rekomandimeve nga Konkluzionet e përbashkëta të Dialogut Ekonomik dhe Financiar në mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë të datës 17 maj 2019.
4. Ministri i Financave koordinon procesin e hartimit të PRE në cilësinë e Koordinatorit Nacional të Programit për Reforma Ekonomike. Koordinatori Nacional i Programit për Reforma në Ekonomi mbështetet nga:
 - 4.1. Zyra për Planifikim Strategjik e Zyrës së Kryeministrit (ZPS) për agjendën e reformave strukturore, që përfshijnë politikat publike sipas fushave të përcaktuara nga Udhëzuesi i Komisionit Evropian;
 - 4.2. Departamenti për Politika Makroekonomike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar (Ministria e Financave) lidhur me kornizën makro-ekonomike dhe politikat fiskale, duke përfshirë masat mbështetëse fiskale.
5. Me qëllim të koordinimit të procesit të përgatitjes së PRE, përkatësisht prioritetet e reformave strukturore, Koordinatori Nacional, fton Sekretarët e përgjithshëm të Ministrive/Institucioneve përkatëse, të emërojnë koordinatorët e fushave.

6. Koordinatorët e emëruar nga Sekretarët e përgjithshëm të ministrive përgjegjëse për fushat e mëposhtme, përbëjnë ekipin qendror të procesit të hartimit të PRE-së:
 - 6.1. Reformat në tregun e Energjisë dhe Transportit;
 - 6.2. Bujqësia, Industria dhe Shërbimet;
 - 6.3. Mjedisi biznesor dhe zvogëlimi i ekonomisë informale;
 - 6.4. Hulumtimi, zhvillimi dhe inovacioni (HZHI) dhe Ekonomia Digjitale;
 - 6.5. Reformat lidhur me Tregtinë;
 - 6.6. Arsimi dhe shkathtësitë;
 - 6.7. Punësimi dhe Tregu i punës;
 - 6.8. Gjithëpërfshirja dhe mbrojtja sociale.
7. Zyra për Planifikim Strategjik në koordinim me koordinatorët përkatës të emëruar sipas pikës paraprake të këtij vendimi krijojnë nëngrupet punuese për secilën prej 8 fushave të mësipërme.
8. Në procesin e hartimit të PRE përfshihen gjithashtu përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, sektorit privat dhe partnerëve të tjerë për të dhënë kontributin e tyre në përzgjedhjen e prioritetëve të reformave strukturore si dhe drafti i PRE-së do të vendoset për konsultim publik (të jashtëm) në platformën për konsultime publike.
9. Duke u bazuar në këtë vendim, ZPS në koordinim me Koordinatorin Nacional për PRE do të përgatis një kalendar të procesit të hartimit të PRE-së dhe do të ndajë atë me ministrinë përkatëse.
10. Zyra për Planifikim Strategjik, sipas kalendarit të theksuar në pikën 8, i prezanton Koordinatorit Nacional listën e njëzet (20) masave të reformave strukturore të rekomanduara sipas metodologjisë për priorizimin e masave.
11. Koordinatori Nacional për PRE, i prezanton Kryeministrit përmes Komisionit për Planifikim Strategjik, listën e reformave strukturore të dakorduara në kuadër të Grupit Qendror për përgatitjen e PRE.
12. Drafti final i Programit për Reforma Ekonomike 2020-2022 aprovohet nga Komisioni për Planifikim Strategjik para se të dërgohet për miratimin përfundimtar në Qeveri.
13. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/108
Datë: 25.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 9, 10, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronës së paluajtshme ish shoqërore parcela nr.1188-0 ZK Hajvali, Komuna Prishtinë, e cila preket nga realizimi i projektit "Rregullimi i shtratit të Përrockës në Hajvali" me qëllim të mbrojtjes së mjedisit, sipas tabelës pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore (MMPH), Ministria e Financave, Agjencia Kosovare e Privatizimit(AKP) dhe Komuna e Prishtinës.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/108

Datë: 25.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 9, 10 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronës së paluajtshme të pronarit/es ose zotëruesve të interesit e cila preket nga realizimi i Projektit për zgjerimin e mihjes sipërfaqësore për eksploatim të thëngjillit për prodhim të energjisë elektrike për nevoja të Korporatës Energjetike të Kosovës(KEK-sh.a), Zona Kadastrale: Shipitullë, Komuna Obiliq, sipas tabelës pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit(MMPH), Ministria e Financave dhe Korporata Energjetike e Kosovës (KEK-sh.a).
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/108
Datë: 25.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Lirohet nga pagesa e tarifave të aeroportit dhe tarifat për shfrytëzim të shërbimeve të trafikut ajror, shërbimeve meteorologjike dhe shërbimeve aeronautike, operatori, Aeroklubi Aviation Enthusiasts Society.
2. Aeroplani i operatorit mund të vazhdoj të përdoret në pajtim me marrëveshjen në mes të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave dt. 09.12.2016, vetëm për fluturime të reagimit në fatkeqësi natyrore, evakuime mjekësore nga ajri dhe nevoja tjera urgjente, në pajtim me marrëveshjen dhe nenin 82, par. 1 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil.
3. Obligohet Ministria e Infrastrukturës dhe Autoriteti i Aviacionit Civil të ndërmarrin masa për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 10/108
Datë: 25.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 17 paragrafi 1. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit për lidhjen e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për transport rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave.
2. Obligohet Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit që të zhvillojë negociata me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes së lartcekur, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 11/108
Datë: 25.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 17 paragrafi 1. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Financave për negocimin e Marrëveshjes së Grantit në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW), për financimin e projektit "Mënjanimi i ujërave të zeza në Kosovën Jugperëndimore - FAZA VI".
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Financave obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 12/108
Datë: 25.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr. 02/104, i datës 23.05.2019.
2. Obligohet Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit, në koordinim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, t'i inkorporojë ndryshimet në tekstin e Projektligjit për Pyjet.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin sipas këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/108
Datë: 25.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 14 pika 6 të Ligjit Nr. 06/L-133 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rialokimi i mjeteve në shumë prej 1,501,445,00€, në buxhetin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, nga projekti: "Bashkëfinancim me donatorë për skemën e granteve bazuar në performancën komunale" me kod 15525 në 30 (tridhjetë) projekte kapitale në përputhje me 30 (tridhjetë) marrëveshjet e mirëkuptimit të nënshkruara nga MAPL, kryetarët e komunave përkatëse si dhe donatori.
2. Projekti "Bashkëfinancim me donatorë për skemën e granteve bazuar në performancën komunale" me kod 15525, ka nga dy burime të financimit, ku vlera prej 1,000,000.00€ janë të hyrat nga AKP dhe vlera prej 501,445.00 janë të hyra nga Granti Qeveritar.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë